**R E P U B L 1 K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**

**B A S H K I A  L I B R A Z H D**

**Data 20.03.2024**

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TE VECANTA PËR KUALIFIKIM**
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKT**I I PROCEDURËS:Sistemim asfaltim i rruges Funares-Zdranjsh,Njesia Administrative Orenje ,Bashkia Librazhd.

---

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Asfalt-44113620-7**

**VLERA** E FONDIT LIMIT:  75 000 000 (shtatedhjete e pese milion)leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## A. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*
*c. Formularin e ofertes sipas shtojces 1*

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme **(2020, 2021, 2022)**, në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2020, 2021, 2022** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika"c", "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve, *kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

*Shëmin:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme ështëvendosurreferuarnenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "PërMiratimin e RregullavetëProkurimit Publik", sidhebazuarnëNenin 77 pika 3,

e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "PërProkurimin Publik", sidheLigjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës se përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
Dhe /ose
*b)* Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e puneve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpallje së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël sedyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**.**

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim****. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë* ***të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht****.* ***Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim****.*

**2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:**

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
  - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  - Situacionin përfundimtar të objektit;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Fatura tatimore.
  - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimt të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura

tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
- Akt kolaudimi objekti;
- Fatura tatimore
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.3** Operatori Ekonomik, duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST), se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se 100 (njeqind) punonjës me kohe te plote, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit te prokurimit për periudhën Shtator 2023 – Janar 2024.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që, nga operatori ekonomik të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën shtator 2023 - janar 2024.

b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit te çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per

objektin e prokurimit, orëve të punës, afatit kohor te realizimit te kontrates si dhe shperndarjes se punes. Ne numrin e përcaktuar për fuqine punetore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

**2.3.4** Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatësë të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP– 1 B Punime gërmimi në tokë.
- NP– 4 D Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
- NP– 12 C Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS- 4 C Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to…
- NS- 18 B Punime topogjeodezike

*Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008).*

**Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

**Argumentimi***:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin 5ublic", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi"*, i ndryshuar me VKM nr *92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.*

*Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit..*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

| *Kategoria e kërkuar* | *Pershkrimiikategorisësipaslegjislacionittëfushës* | *Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen* | *Niveli i klasifikimit i kërkuar* | *Vlera e punimeve që parashikoh* |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | *në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse* | *për kategorinë respektive* | *en të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse* |
| NP-1 | Punime gërmimi në tokë”: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.<br><br>mimi në tokë. | Punime germim dheu te themeleve te rrugeve me zinxhir deri ne 50 cm eskavator dhe shkarkim ne toke | B | 21-50 milion |
| NP-4 | Rrugë, mbikalime, ura, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pistaaeroportuale | Punime per bazamentin e rruges dhe shtresat konsumuese te rruges . | D | 101-200 milion |
| NP-12 | Punime te inxhinierise se mjedisit | Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshë | C | 51-100 milion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | m të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme. | | |
| NS-4 | Punime rifiniture te muartures dhe te lidhura me to | Punime suvatimi , veshje e bojatisje | C | 51-100 milion |
| NS-18 | Punime topogjeodezike. | Punimet per piketimin e pjerresive terthore te rruges sipas [projektit | B | 21-50 milion |

**2.3.5 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet.**

**2.3.5/1** Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të paraqesë/in me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në DST:
Se disponon në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërise, inxhinierët e mëposhtëm:

- 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi Infrastrukture Transporti**
- 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (nje) **Inxhinier Mekanik**
- 1 (një) **Inxhinier Gjeoded (Topograf)**
- 1 (nje) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**
- 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**

Inxhinierët e sipërcituar, duhettë figurojnë si **drejtues teknik në liçensën** e Operatorit Ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **shtator 2023 – dhjetor 2023.**

Për inxhinierët, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës (të vlefshme);
- Diplomat përkatëse;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **shtator 2023 - dhjetor 2023.**

**2.3.5/2** Operatori pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplome, si dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt **shtator 2023 - dhjetor 2023**, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - Profili Gjeoteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi - Profili Transport 1( nje)
- Arkitekt 1 ( nje)

***Shënim:Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kritereve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.***

***Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:*

| | |
|---|---|
| *1 (nje) Inxhinier Ndërtimi profil Transport* | *Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime Germimi dhe Prishje, punimet per nenshtrasat rrugore , shtresat asfaltike sipas kuotave te dhena nga ing gjeodet )* |
| *1 (nje) Inxhinier Ndërtimi* | Eshte pergjegjes per pjesen e punimeve te muratures dhe pjeses tjeter te punimeve ndertimore |

| | |
|---|---|
| *1 (nje) Inxhinier Mekanik* | Eshte pergjegjes per punimet mekanike te tenderit |
| *1 (nje) Inxhinier Gjeodet* | *Eshtë përgjegjës për punimet per profilat terthore duke dhene pjerresite sipas kushteve te zbatimit* |
| *1 (nje)Inxhinier Hidroteknik* | Per pjesen e punimeve hidroteknike dhe te problematikave te ndryshme hidro te objektit |
| *1 (nje) Inxhinier Mjedisi* | Kerkohet inxhinier mjedisi pasi kemi te bejme me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate zbatimit te projektit, eshte e pashmangshme qe ne realizimin e punimeve te kete mbeturina e inerte te cilat paraqesin rrezikshmeri per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale, prandaj asistenca e nje inxhinieri mjedisi do te jete e domosdoshme. |
| *1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik* | *Strukturat mbajtese te dheut, permiresime bazamentesh te rrugeve et. Gjithe preventive parashikon zera ku eshte e nevojshme prania e ing.gjeoteknik* |
| *1 ( nje) Inxhinier Ndertimi profili Gjeoteknik* | *Strukturat mbajtese te dheut, permiresime bazamentesh te rrugeve et. Gjithe preventive parashikon zera ku eshte e nevojshme prania e ing.gjeoteknik* |
| *1 ( nje) Inxhinier Ndertimi profili Transport* | *Preventivi parashikon nderhyrje ne rruge e sheshe ku kerkohet prania e ing. Ndertimi profile transport,*<br><br>*Punime ne rruge nga parkimi nr 1 deri te dalja nga spitali..* |
| *1 (nje) Inxhinier Topograf* | Eshtë përgjegjës për punimet per profilat terthore duke dhene pjerresite sipas kushteve te zbatimit |

**2.3.5/3** Operatorët ekonomik pjesemarres të kenë në stafin e tyre min. 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", e cila të jetë e lëshuar nga shoqeritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga

Republika e Shqiperisë. Për këta specialistë të paraqiten kontrata e punës, diploma dhe çertifikata përkatese e dhënë nga një organizëm i liçensuar shqiptar ose i huaj si dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën shtator 2023 - dhjetor 2023.

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.***

**Argumentimi:**

Specialiste per ndihmen e pare jane te nevojshem per shkak te profileve te ndryshme te puneve dhe te terrenit, per kete arsye eshte parashikuar qe operatori ekonomik te kete nje person, pa percaktuar profesionin e tij i cile te kete nje trainim me special per dhenie te ndihmes se pare. Ne objekt do te kryhen punime te natyrave te ndryshme ne keto kushte duhen parashikuar dhe parandalimi i problematikave te mundshme shendetesore.

**2.3.5/4.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë (***sipas shtojcës 8 të DST***) se ka minimumin punonjës specialist për kryerjen e punimeve, dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën **shtator 2023 - dhjetor 2023,** si më poshtë:

**3 (tre) Teknike ndertimi** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar.

**1 (nje) Teknik Topograf/Gjeodet** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**1 (një) Teknik i mesem Mekanik** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**1 (nje) Teknik i mesem Elektroteknik** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**1 (nje) Teknik i mesem Gjeometer** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**1 (nje) Teknik i mesem Termohidralik** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**6 (gjashte) Murator** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**10 (dhjete) Saldator** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024

**10 (dhjete) Karpentier** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**5 (pese) Gurthyes** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 – janar 2024;

**2 (dy**) elektriciste shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**2 (dy) Elektricist** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë". si dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**15 (pesembedhjete) Punetor Asfalti** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**10 (dhjete) Hekurkthyes** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**2 (dy) Punonjes Punime Mekanike** shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqërisë minimumi për muajt shtator 2023 - janar 2024;

**Ekskavatorist/Automakinist Manovrator 8 (tete),** me kontratat e punës (të vlefshme) dëshmi e aftësise profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per shtator 2023 - janar 2024**.** te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të deklarojë (***sipas shtojcës 8 të DST***) se ka të punësuar punonjes me dëshmi te aftësise profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor si me poshte:

**Buldozerist 2 (dy**), me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësise profesionale per perdorimin e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhen shtator 2023 - janar 2024, te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar.

**Shofera Kamioni 6 (gjashte),** me kontratat e punës (të vlefshme), leje drejtimi minimalisht kategoria C (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per shtator 2023 – janar 2024**.** te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te

Leshuara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001, i ndryshuar

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.***

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

| Nr | Emer Mbiemer | Profesioni | Data e fillimit te marredhenievet punes | Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale | Institucioni/ Subjekti certifikues | Data e vlefshmerise se certifikates |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

( plotesimi i tabeles eshte i detyrueshem per operatoret e konomike qe ne fazen fillestare te konkurimit)

**Argumentimi :** Kerkesat e mesiperme jane vendosur ne zbatim te ligjit 162/2020 Per prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datw 19.05.2021 " Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" neni 39 pika 6  Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose  ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren *"Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të*

*rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”,* miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**2.3.7** Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si *“**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**”* në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.*

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”*, e dhënë nga një organizëm i liçensuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – janar 2024 (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesemarrjen ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktemarreveshje).*

Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si *“**Koordinator i Sigurise**”* në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.*

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për *“Koordinator i Sigurise* e dhënë nga një organizëm i liçensuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – janar 2024 (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës " Koordinator i Sigurise” ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesemarrjen ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktemarreveshje).*

Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si *“**Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis**”* në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS.

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për *“Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis* e dhënë nga një organizëm i liçensuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – janar 2024 (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës " Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis” ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesemarrjen ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktemarreveshje).*

**Argumentimi**

i pikës 2.3.7, të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësiperme mbështetet në ligjin nr. Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit. Në rregulloren për mbrojtjen e dhe vleresimin e demeve ne mjedis punedhenesi zgjedh nje ose disa persona pergjegjes per vleresimin dhe parandalimin e risqeve te demeve ne mjedis.

Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si ***"Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis*** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS.

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për *"Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis"* e dhënë nga Ministria e Mjedisit, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – janar 2024 (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës " Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis" ne perputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesemarrjen ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktemarreveshje).*

Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si ***"Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore"*** në përputhje me klauzolat e VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore" dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore".

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, çertifikata e trajnimit për *"Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore"* e dhënë nga organizma te certifikuara, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2023 – janar 2024 .

**Argumentimi**

i pikës 2.3.7, të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësiperme mbështetet në VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore” Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë rrugore. Në rregulloren për mbrojtjen e dhe vleresimin e sigurise rrugore punedhenesi zgjedh nje ose disa persona pergjegjes per vleresimin dhe parandalimin e risqeve te demeve ne mjedis..

**2.3.8** Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteveSSH EN SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

***Argumentimi****:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues të figurojë në listpagesat e shoqerise per periudhen shtator 2023 - janar 2024, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

***Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST***

**Argumentimi :** i pikës 2.3.11 të kritereve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhenieve kontraktore me individe apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

**<u>2.3.10</u>** Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme" & III.2.B **"Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza**. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë")

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: "*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*".Në shtojcën 1/B eshte listuar edhe veprimtaria "Menaxhimi i mbetjeve".

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikohet se: "*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri*".

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*": "*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*".

<u>Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi</u>

**<u>2.3.12</u> Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera; Dëshim për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (***shtojca 8***), për mjetet dhe paisjet si më poshtë:

| Mjetet | Sasia | Pronësia |
| --- | --- | --- |

| | | |
|---|---|---|
| Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton | 10 cope | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 10-17 ton | 7 cope | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 10-15 ton | 3 cope | Pronësi ose me qera |
| Kamion 8 ton min deri ne 10 ton max | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion me vinç min 6 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 3.5 ton min – 5 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 2.5 ton min – 3 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 1.5 ton min – 2 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Kamion me kapacitet mbajtes 1 ton min – 3 ton max | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Koke terheqese | 2 cope | Pronësi ose me qera |
| Rimorkio me kapacitet mbajtes mbi 70 ton | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Rimorkio me kapacitet mbajtes mbi 30 ton | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Autovinc me pesh ngritese 60 ton per levizjen e tubave te celikut dhe tombinove | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Rul Gome – Hekur mbi 18 ton | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Rul Gome hekur mbi 14 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Rrul Gome Hekur 8-10 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Rul asfalti hekur hekur 1-3 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Rrul hekur hekur mbi 8 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere | 8 copë | Pronësi ose me qera |
| Autopompë betoni | 5 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobitumatrice | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Grejder me targa | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Dumper me goma me targa | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Minifafrome me goma me targa | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me goma | 4 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobot Uji me kapacitet min 15,000 litra | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Autobot Uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator me zinxhir me kove 1 m3 | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Buldozer | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Asfaltoshtruese | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Fshese Asfalti | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri Vijezimi | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri per vendosjen e guarderilave | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Germues i superstruktures me rrotullim 360 | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Fadroma me goma me kove para dhe mbrapa | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Autovinc me kosh | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Cekic pneumatik | 2 copë | Pronësi ose me qera |

| | | |
|---|---|---|
| Depozitë uji 5000 litra | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Motopompë uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Pompë zhytese per ujra te ndotura me prurje >100 L / min | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Aparat saldimi tub plastik me elektrofuzion 20 mm – 1200 mm | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Aparat saldimi per ngjitje tub plastik kok me koke | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Panele armature betoni | 500 m2 | Pronësi ose me qera |
| GPS | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Vibrator betoni | 4 copë | Pronësi ose me qera |
| Deflektometer | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Tokmak | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Elektroargan | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Gazogjen | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Prerëse asfalti | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Kalander per punimin e Metalit | 1 copë | Pronesi ose me qera |
| Zmerilatrice | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Nivelues me laser | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Saldatrice | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Gjenerator 18 kva | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Gjenerator 66 kva | 1 cope | Pronësi ose me qera |
| Betoniere kantieri | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Pompe uji | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Matrapik | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Nyje prodhimi inertesh e pajisur me Leje Mjedisi | 1 copë | Në pronësi ose me qira /ose kontratë furnizimi III.1.B,IV.1.B,III.I.A |

**-Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:**

**A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).

4. Çertifikata e transportit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

**B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten**

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).
4. Kontrata përkatëse e qirasë, (e vlefshme).
5. Çertifikata e transportit për të tretë ose në emër të qeramarrësit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

**C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

**D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:**

1. Fatura tatimore të blerjes, akt zhdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qirasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.
Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.3.13** Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) ***sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së***. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**2.3.14**. Operatori/et ekonomik ofertues, duhet të deklarojë që, të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara në pikën 2.3.12 të Kapacitetit Teknik, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, **janë shkak skualifikimi.** Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik“

**2.3.15** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme) si më poshtë:

- **Çertifikatë S SH EN-ISO 9001-2015**ose ekuivalenti i tij *(Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme).* Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë S SH EN-ISO 14001-2015** ose ekuivalenti i tij *(Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme).* Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë SSH ISO 45001:2018** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

  **Çertifikatë SSH ISO 50001:2018** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të energjise ). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit
  **Çertifikatë SSH ISO 27001:2013** ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të sigurise se informacionit). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes).
Nëse ofertuesi do të paraqitet si Bashkim Operatorësh, çertifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra sa më sipër.

**Argumentimi :** Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

**2.3.16 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

- Pllaka Troturari betoni,Bordura betoni,Tombino betoni.
  Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi KODI III.1.B Leje Mjedisi Tipi B per Perzierja e cimentos ose perdorimi i cimentos ne mase te madhe por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe perzierjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos, si dheKODI III.1.A Autorizim mjedisor për projektin: "Prodhime elemente betoni dhe materiale ndërtimi"), Fabrika ose Distributori te jete jo me larg se 50 km nga objekti. eshte kerkuar largesia 50 km per faktin se duke mare parasysh terrenin malor te objektit si dhe kohen e fillimit te ngurtesimit te betonit,ka kushte te vecanta per transportin e betonit,kjo mbeshtetur dhe ne KTZ-81 dhe Vendimin nr.679, datë 22.10.2004 për Miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore.ku thuhet: Humbja e punueshmërisë është një fenomen që vihet re në orën e parë ose maksimumi në dy orët e para nga momenti i prodhimit të betonit. Transporti është faktor shumë i rëndësishëm i cili ka ndikim të madh mbi cilësinë e betonit. Elementet themelore në bazë të cilëve planifikohet transporti janë: lidhja e parakohshme dhe segregacioni i betonit. Përveç kësaj, transporti duhet të jetë i shpejtë, racional,të sigurojë mbrojtje nga avullimi i ujit, rrjedhja e qumështit të çimentos etj.. Koha maksimale orientuese për transport është Temperatura e betonit të freskët°C 5-10, 10-20 ,20-30 Koha maksimale për transport (min) 120 ,90, 45
  Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).
  Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes nedorezim.

- Tubo HDPE dhe PVC.
  Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi I plastikes) dhe certifikatëne cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme ISO 45001 dhe ISO 14001. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet dhe kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme.
  Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).
  Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim.

- Boje per vijezimet pasjisur me certifikatat e cilesise dhe Raport Testimi

- Shtylla Elektrike,Ndricues LED,Elektroda,Kabell Kabell 0,6/1 KV ; tip RG7R ; 4x10mm2 & Kabell 0,6/1 KV ; tip RG7R ; 3x1,5mm2 Shoqeruar me certifikat cilesie
  Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara si dhe ISO 9001 ,14001 ,45001

***Shenim:***Referuarpikës1,tënenit26,tëVKMnr.285,datë19.05.2021, i ndryshuar**,** ku parashikohet : "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/entikontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetetpublike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82,të LPP-së, dhe në këto rregulla",* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:"***Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/entikontraktori kërkon ofertuesit të kualifikuar, ipari** dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentete tjerashoqëruesetëofertës,tëdorëzuaranërrugëelektronike.Këtodokumenteduhettëparaqiten nëorigjinal osenëkopje tënjësuarameorigjinalin*

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në **gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës),** të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të çertifikuara "Apostile". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Gjithashtu operatori ekonomik duhet te dorezoje :

- Grafiku i punimeve sipas te gjitha zerave te preventivit dhe afateve te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.
- "*Planin e Sigurisë në Kantier*" për punimet në objekt në formatin sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 "*Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë*", të ndryshuar me VKM-në Nr.742 datë 06.11.2003.
- Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit

***Argumentimi**:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre "(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë

në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Argumentimi i specifikimeve teknike :**

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit dhe relacionet teknike përkatëse, bashkëlidhur DT-ve, të hartuara nga shoqëria projektuese.

Vendosja dhe argumentimi i kritereve lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku cilësohet se: “Në rast se nuk janë krijuar struktura të posaçme, detyrat e mëposhtme kryhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit :

- Hartimi i specifikimeve teknike;
- Përllogaritja e fondit limit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimi i kritereve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).

Pas hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit dhe kritereve për kualifikim Njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3, të manualit teknik “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, miratuar me udhëzimin nr. 07, datë 30.7.2021 të APP, si dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, vendosi si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave

**NJËSIA E PROKURIMIT**